

KOÇO BIHIKU**MBI DISA PROBLEME TË STUDIMIT TË HISTORISË SË LETËRSISË SHQIPE**

Shkenca jonë për letërsinë, e udhëhequr nga metodologjia marksiste-leniniste, ka arritur suksese të rëndësishme në rrugën e saj. Në goftë se para çlirimit kërkimet në këtë fushë ishin të kufizuara dhe sporadike, sot është formuar një shkencë shqiptare për letërsinë, e cila ka përpunuar një varg problemesh qendrore të historisë së letërsisë.

Duke u mbështetur në tezën marksiste-leniniste të dy kulturave në kulturën kombëtare dhe duke shfrytëzuar rezultatet e studimeve historike të pasçlirimit, shkenca jonë për letërsinë përpunoi në vija të përgjithshme një koncept të drejtë mbi zhvillimin historik të letërsisë shqipe, mbi bazën e të cilit u hulumtuan një sërë problemesh historikoletrare, u hartuan studime dhe punime monografike për përfaqësuesit më të shquar të letërsisë së kaluar, për N. Frashërin, A. Z. Çajupin, J. de Radën, N. Mjedën, Z. Seremben, G. Dara të Riun, F. S. Nolin, Migjenin, Asdrenin etj. Gjatë kësaj pune u sollën materiale të reja arkivale dhe u zbuluan vepra të reja të cilat e pasuruan përfytyrimin tonë mbi kuadrin e zhvillimit historik të letërsisë shqipe.

Suksesi i rëndësishëm i shkencës sonë për letërsinë është hartimi i Historisë së letërsisë shqipe. Kjo vepër, botuar nga Instituti i historisë dhe i gjuhësisë më 1959, duke përgjithësuar rezultatet e arritura deri atëhere, dha një interpretim të ri shkencor të rrugës historike të përshkuar nga letërsia shqipe nga fillimet e deri pas çlirimit.

Ndër sukseset e tjera duhet numëruar edhe botimi i veprave të shkrimtarëve përparimtarë të së kaluarës, shoqëruar me studime hyrëse dhe shënime tekstologjike e historikoletrare, që u ndihmojnë masave të lexuesve të kuptojnë drejt trashëgimin tonë letrar.

Me gjithë këto rezultate, përpara shkencës për letërsinë qëndrojnë probleme të shumta, të cilat presin që të studjohen dhe të sqarohen mbi baza shkencore. Mjaft syresh paraqesin jo vetëm interes thjesht historikoletrar, por fitojnë një rëndësi ideologjike të dorës së parë në dritën e materialeve të Kongresit V të PPSH, të dokumentave të reja të partisë dhe sidomos të fjalimeve të rëndësishme të shokut Enver Hoxha mbi çështje të ndryshme të revolucionarizimit të jetës së vendit.

Për të zgjidhur këto probleme është e domosdoshme që të përcaktohen në mënyrë objektive sukseset dhe të metat e vërejtura në fushën e studimeve historikoletrare dhe, mbi bazën e përvojës pozitive, të ecet më tej me qëllim që shkenca jonë për letërsinë t'u përgjigjet kërkesave të reja të kohës.

* * *

Qoftë për shkak se që më parë ekzistonte një farë tradite, qoftë edhe sepse pas çlirimit, për t'ju përgjigjur kërkesës të shkollës së re për sqarimin e traditave përparimtare në letërsinë e kaluar, pjesa më e madhe e studjuesve u hodh në këtë fushë, letërsia e Rilindjes kombëtare është sot periudha më e studjuar e historisë së letërsisë shqipe.

Synimi për ta studjuar historinë e letërsisë së kësaj epoke në lidhje me jetën e popullit, me luftën e tij për të flakur tej zgjedhën e huaj qindravjeçare dhe për të hyrë në rrugën e zhvillimit demokratik, në lidhje me përpjekjet e tij për liri, tokë, dritë dhe përparim si dhe zbulimi e shfrytëzimi i një materiali të ri të nxjerrë nga arkivat ose nga shtypi periodik i së kaluarës, bënë që shkencën jonë për letërsinë ta rikthojë përfytyrimin e vjetër, të njëanshëm mbi letërsinë shqipe të kësaj periudhe të rëndësishme të historisë kombëtare. Si rezultat i kërkimeve të reja të historianëve tanë mbi karakterin e lëvizjes politike, ideologjike dhe kulturele të fundit të shek. XIX dhe të fillimit të shek. XX, u sqarua se letërsia shqipe e kësaj periudhe, përveç karakterit patriotik, shquhet edhe nga një frymë e theksuar demokratike. U vunë në dukje motivet antif feudale dhe demokratike në veprën e shumë autorëve përparimtarë si të A. Z.Çajupit, Asdrenit, R. Siliqit etj. dhe në mënyrë të veçantë në shtypin e fillimit të këtij shekulli (M. Grameno etj.), për të cilat heshtej në tekstet dhe në studimet e paraçlirimit. Edhe vetë fryma patriotike e veprave letrare të periudhës së Rilindjes u ndriçua mbi bazën e koncepteve të reja ideologjike dhe në kontekstin e luftës shoqërore-politike të epokës.

Por në përpjekjet për të vënë në pah në mënyrë sa më të plotë veprat e letërsisë shqipe të Rilindjes, u bënë edhe disa gabime, që u shprehën në zmadhimin e meritave të personaliteteve letrare të kësaj epoke. Në mjaft raste nuk u fol për anët negative në pikëpamjet dhe në veprën e shkrimtarëve të Rilindjes kombëtare ose u paraqitën ato si elemente pozitive. «Po të shohim me kujdes zhvillimin mësimor të letërsisë sonë dhe të huaj, në shkollë dhe jashtë shkollës (dhe këtë duhet ta studjojmë me imtësi në dritën e filozofisë sonë), — tha sh. E. Hoxha, në fjalën e mbajtur në Byronë Politike më 7 mars 1968 lidhur me revolucionarizimin e shkollës sonë, — do të konstatojmë jo vetëm dobësi, çrregullime dhe shpërpjestime, amatorizëm, pasione dhe erudicion të sëmurë, por edhe gabime të rënda që na kushtojnë dhe do na kushtojnë më rëndë më vonë, në rast se nuk i koregjojmë»¹.

Kritika parimore e shokut Enver lidhur me idealizimin që i është bërë në tekstet dhe në studimet tona një radhë figurash të letërsisë së Rilindjes kombëtare si N. Frashërit, N. Mjedës etj., shtron përpara studjuesve detyrën e rivlerësimit të trashëgimit tonë letrar nga pozita më të shëndosha ideologjike dhe shkencore.

S'ka dyshim se N. Frashëri është një figurë e shquar e Rilindjes sonë, që u përpoq për çlirimin kombëtar dhe përparimin shoqëror e kulturor. Në studimet dhe në artikujt kushtuar shkrimtarit është zbuluar në mënyrë të plotë kjo përmbajtje ideore përparimtare e veprës së tij. Po në krijimet e poetit kanë gjetur pasqyrim edhe kufizimet e botë-

1) E. Hoxha, *Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë*, Tiranë, 1968, f. 33.

kuptimit të tij. Për të ishte karakteristik humanizmi abstrakt, thirrja për harmoni dhe dashuri midis të gjithë shqiptarëve pa bërë dallim, se cilët janë patriotët dhe cilët janë tradhëtarët. Dhe këtu nuk është fjala për «utopi», për mungesë realizmi në gjykimin e gjërave, siç përpiket ta nxjerrë Dh. S. Shuteriqi². Në këtë rast kemi të bëjmë me një kufizim klasor të N. Frashërit. Në predikimin e harmonisë, që linte në heshtje mosmarrëveshjet midis bejlerëve dhe masave të popullit, u shpreh një nga tiparet kryesore të ideologjisë së poetit, i cili bënte pjesë në inteligjencën borgjeze me origjinë feudale.

Zbukurimi i figurës së N. Frashërit u duk edhe në përpjekjet për t'i veshur atij pikëpamje materialiste. Disa studjues, duke u nisur nga librat e leximit për shkollat, në të cilat shkrintari përhap realizimet e shkencave të natyrës si: shpjegimin shkencor të origjinës së njeriut, të lindjes së botës bimore dhe të kafshëve dhe të krijimit të sistemit diellor, janë orvatur ta paraqesin botëkuptimin e poetit gati-gati materialist. Pa dyshim, kjo nuk është e saktë, sepse bazat e botëkuptimit të tij mbetën deri në fund idealiste. Raportin e mendimit ndaj qenjes. N. Frashëri e zgjidh në favor të mendimit, të shpirtit. Për poetin, zoti është kryeshkaku i gjithshkaje. Bota përreth është shfaqje e perëndisë, e cila është shkrirë në sendet e natyrës dhe në vetë njeriun. Ndonjëherë atij i shpëton ndonjë fjalë skeptike për ekzistencën e botës së përtëjshme, por në thelb beson në parajsën dhe në skëterrën. Për thelbin idealist të sistemit të pikëpamjeve të N. Frashërit flet qartë besimi i tij në pavdekësinë e shpirtit. Shpirti, sipas tij, nuk vdes bashkë me trupin, por rron pas zhdukjes së tij, duke kaluar te njerëzit e tjerë. Po të kemi parasysh këto, bëhet e qartë, se mendimi që N. Frashëri me librat e veta ka ndihmuar për të forcuar tek nxënësit botëkuptimin materialist³, nuk i përgjigjet së vërtetës.

Lidhur me sa u tha më sipër del detyra që krijimtaria e poetit të shquar të studjohet në mënyrë të gjithanshme e kritike, duke vënë në dukje si anët pozitive që e kishin burimin në karakterin e gjërë demokratik të lëvizjes së Rilindjes kombëtare, ashtu edhe kufizimet ideore, të cilat vinin nga fakti se poeti nuk i këputi krejtësisht fijet që e lidhin me ideologjinë e ambientit shoqëror nga kishte dalë.

Më me këmbëngulje e në mënyrë sistematike u bë zbukurimi i figurës së Mjedës. Disa autorë kanë bërë çmos për ta lidhur krijimtarinë e poetit me rrymën ideore të intelektualëve demokratë mikroborgjezë, të cilët zinin pozitativat më radikale në lëvizjen kombëtare. Në studimet dhe në artikujt e botuar katër-pesë vjetët e fundit, Mjeda përshkruhet si ideolog i fshatarësisë punonjëse, luftëtar i vendosur për çlirimin e saj nga zgjedha e feudalëve. Mjeda, pohon M. Gurakuqi, «mori gjithmonë anën e të shtypunve e të të mundumve jo për të qamë e vajtue pa shpresë e pa rrugëdalje, por për t'i nxitë, për t'i bamë të qendrojnë, të ngrejné krye e të luftojné».⁴ Kurse në një vend tjetër ky autor shkruan: «Te poezia e Mjedës, tema e dytë themelore asht ajo shoqnorja e pame në shumëanëshmëninë e saj: në antifeudalizmin e përcaktuar dhe konsekuent të poetit, në demokratizmin e tij që konkretizohet në kërkesën dhe për liri shoqnore, në besimin në masat e vorfna popullore e sidomos në

2) *Historia e letërsisë shqipe*, v. II, botim i Institutit të historisë dhe të gjuhësisë, Tiranë, 1951, f. 302.

3) *Po aty*, f. 301.

4) M. Gurakuqi, *Jeta dhe vepra e N. Mjedës*, Tiranë, 1967, f. 5.

fshatarë e në dashuninë aktive për to, në qëndrimin e tij antiimperialist e antikolonialist, në vetë shtjellimin e motiveve shoqërore, në vendin që ze puna në poezinë e tij etj.»⁵

S'ka dyshim, se këtu kemi të bëjmë me një përfytyrim të shtrembër mbi pozitën ideore të Mjedës. Pikëpamja mbi Mjedën si luftëtar i vendosur dhe konsekuent kundër dhunës dhe shfrytëzimit të feudalëve vjen nga një kuptim jo i drejtë i qëllimeve dhe i aspiratave të Mjedës si pjesëmarrës i lëvizjes për çlirimin kombëtar dhe në rrjedhojë të kësaj edhe i thelbit të krijimtarisë së tij. Një koncept i tillë mbi Mjedën është ndërtuar mbi trajtimin e njëanshëm dhe jo të saktë të disa të dhënave biografike të poetit, sidomos të marrëdhënjëve me Urdhërin jezuit.

Nga hetimi i kujdesshëm i fakteve që njihen dhe i veprimtarisë së Mjedës pas largimit nga Urdhëri jezuit, del pak a shumë qartë, se konflikti i tij me krerët e Urdhërit në fjalë kishte karakter vetëm politik dhe lidhet me rrethanat politike e shoqërore, që u krijuan në Shqipëri në fund të shek. XIX dhe me rolin që luajtën në to jezuitët. Dihet, se kleri katolik e ndër ta edhe jezuitët përkrahnin plotësisht politikën austro-hungareze, e cila kishte si synim vënjen nën kontroll të lëvizjes kombëtare shqiptare, e cila sipas rrethëve drejtuese të Vjenës duhej të zhvillohej brenda caqeve të kërkesave kulturele. Në përputhje me këtë politikë, Urdhëri i jezuitëve bëri çmos për të penguar lëvizjen kombëtare, kur kjo mori rrugën e luftës për zhdukjen e zgjedhës turke. Mbi këtë truall lindi edhe konflikti i krerëve të Urdhërit me Mjedën, i cili si patriot nuk mund të rrinte duarkryq në një çast kaq vendimtar për atdheun. Ai shkroi vjersha të cilat ngjallnin ndjenjën patriotike dhe urrejtjen për të huajin. Me këto poezi dhe me veprimtarinë e vet kulturele ai u përfshi në lëvizjen e përgjithshme popullore për çlirimin e atdheut. Ndryshe nga shkrimtarët e tjerë nga rrethi i klerikëve katolikë, Mjeda, si bir i një lopçari dhe i një rrobalarëseje, e ndjeu veten afër popullit, i kuptoi vuajtjet që i sillte popullit sundimi mizor i pushuesve turq dhe i veglave të tij besnike, feudalëve vendas. Me këtë shpjegohet patriotizmi i fuqishëm dhe i sinqertë, që e çoi poetin deri në pranimin e idesë së kryengritjes popullore për hedhjen tej të zgjedhës së huaj («Liria»). Në lidhje të pandarë me këtë duhet parë edhe qëndrimi «antifeudal» i poetit. Në poezinë «Mustafa Pasha në Babunë» ai u ngrit jo kundër feudalëve si shfrytëzues të pamëshirshëm të fshatarësisë punonjëse, por i fshikulloi ata si tradhëtarë të atdheut, si bashkëpunorë besnikë të administratës turke, pra në kuadrin e luftës për çlirimin kombëtar.

Mjeda, pra, nuk e ka shtruar çështjen e reformave sociale. Për të as që ekzistonte problemi i rendit të padrejtë shoqëror të kohës. Gabimi i disa studjuesve është se daljen e Mjedës nga Urdhëri jezuit e marrin si heqje dorë nga ana e tij, edhe prej ideologjisë fetare, dhe si kalim në pozitën e demokratizmit revolucionar. Duke e ndarë Mjedën — shkrimtar nga Mjeda — prift, ata e nxjerrin poetin si «antifeudal», «antizogist» dhe «demokrat të bindun» dhe harrojnë se pozitën e tij ideore nuk ndryshuan. Qysh në fillim, kur hyri në lëvizjen e përgjithshme patriotike, e deri në fund, kur u tërhoq krejtësisht në jetën private dhe e ndërpreu edhe atë pak veprimtari shoqërore, e cila edhe ashtu kishte qenë e vogël në të kaluarën, Mjeda mbeti vetëm një poet patriot i sinqertë, që luftoi për çlirimin e popullit shqiptar nga zgjedha e huaj.

5) *Po aty*, f. 95.

Për sa i përket qendrimit të tij ndaj problemit social flet qartë poema «Andrra e jetës», ku vërtetë shihet se kishte dhëmshuri për të varfërit, por përveç mëshirës kristjane ai nuk u falte më tepër heronjve të vet të mjerë. Botëkuptimi fetar e pengoi shkrimtarin ta zbulojë këtë problem të rëndësishëm shoqëror që e shqetësonte. Heronjtë e poemës janë shkëputur nga lidhjet shoqërore reale dhe janë vendosur në një ambient konvencional. Kjo paraqitje skematike dhe abstrakte nuk zbulon shkaqet e mjerimit të tyre, e jetës së tyre të varfër, e cila është reduktuar në plotësimin e kërkesave dhe të nevojave më të domosdoshme për të rrojtur. Përveç kësaj pamje të zyrtë të rrojtjes së heronjve dhe ndjenjës së mëshirës së poetit, asnjë ide të rëndësishme shoqërore nuk ka në vepër. Prandaj, nuk mund të mos na habisinin orvatjet e disa studjuesve, të cilët shohin në «Andrra e jetës», thirrje për drejtësi shoqërore, thirrje për të mos ju nënshtruar shtypjes(?)⁶.

Të gjitha këto flasin se në këtë fushë studimesh dalin një varg problemesh të ndërlikuara. Në radhë të parë duhen rishikuar vlerësimet subjektive, të pambështetura në fakte, të cilat kanë penguar që të përcaktohet drejt vendi dhe rëndësia e N. Mjedës në historinë e letërsisë shqipe, pozita dhe lidhjet e tij me lëvizjen për çlirimin kombëtar, duhet të vihen në dukje kufizimet ideore të veprës së tij, të cilat duhet të shpjegohen me botëkuptimin dhe veprimtarinë e tij si klerik. Për këtë qëllim duhet bërë një shoshitje e imtë e fakteve dhe e të dhënave historiko-letrare, duke hequr mënjanë çdo gjë të pavërtetuar e duke mbajtur vetëm ato që kanë vlerë objektive, reale.

Përpjekje për të «ndrequr» historinë duken edhe në synimin e disa studjuesve për të parë në disa shkrimtarë të së kaluarës më tepër elemente pozitive se sa ka në realitet në veprat e tyre, ose për t'i paraqitur ata me pikëpamje politike shumë më të përhapura. Kështu, megjithëse në broshurën e Gj. Zhejit «Andon Zako Çajupi», poeti zagoriot në përgjithësi është karakterizuar drejt si shkrimtar demokrat dhe armik i përbetuar i forcave reaksionare e oportuniste, nuk mund të mos vëmë në dukje krahas kësaj dhe ndonjë formulim, në të cilin Çajupi vizatohet gati-gati si ideolog i fshatarësisë së shfrytëzuar. «Sytë poeti i ka kthyer nga masat fshatare, te forca e të cilëve sheh shpëtimin si dhe udhëheqësit ushtarakë të ardhshëm të luftës për liri»⁷ — lexojmë në këtë vepër. Kuptohet, se këtu thelbi i veprës së shkrimtarit nuk është shpjeguar drejt. Çajupi qëndronte në pozita të përgjithshme demokratike. Orvatja për ta nxjerrë si partizan të kryengritjes fshatare bie në ndesh me faktet e njohura historike.

Ndonjëherë prirja për të zbukuruar faktet e historisë së letërsisë kombëtare mori forma ekstreme subjektivistike. Kështu ndodh me punimin e R. Brahimit «Proza e Ndoc Nikajt», ku shkrimtari, në kundërshtim me të dhënat, pikturohet si antifeudal dhe antiklerikal i vendosur, si përkrahës i aspiratave shoqërore të njerëzve të thjeshtë të popullit, si autor «që ka hymnizuar personalitetin e lirë të njeriut, të drejtën e tij që të jetojë i lumtur dhe synimin e tij që ta gëzojë këtë jetë, pa menduar as moralin hipokrit të klerikëve e të feudalëve»⁸. Në këtë studim është lënë fare mënjanë sqarimi i botëkuptimit dhe i pikëpamjeve politike të

6) M. Gurakuqi, *po aty*, f. 190; R. Brahimi, *Shënime letrare*, Tiranë, 1965, f. 309.

7) Gj. Zheji, *Anton Zako Çajupi*, Tiranë, 1960, f. 52.

8) R. Brahimi, *Shënime letrare*, Tiranë, 1966, f. 334.

N. Nikajt, i motiveve të vërteta të veprimtarisë së tij kulturele dhe letrare. Nikaj ishte përshkrues i shkathët i zakoneve dhe i dokeve patriarkale të fshatit malor të Veriut, i konflikteve të jetës malësore që lindnin mbi truallin e shkeljes së moralit të vjetër në lëmin e marrëdhënjeve intime. Ajo që i bën romanet e tij tërheqëse është fryma poetike, nga e cila shquhen përshkrimet e marrëdhënjeve në mes të rinjve malësorë, mbrojtja e flaktë që i bën së drejtës për të vendosur vetë mbi fatin e vet. Por kjo nuk e bën N. Nikajn as kundërshtar të feudalëve dhe as të priftërinjve. Ai i kritikon zakonet e vjetra nga pozita abstrakte moralistike, si diçka mizore, të egër, që s'pajtohen me natyrën njerëzore. Konservatorizmi dhe fryma fetare përshkon jo vetëm pikëpamjet politiko-shoqërore, por të gjithë botëkuptimin e N. Nikajt.

Në kuadrin e studimit të trashëgimit tonë letrar shkenca jonë për letërsinë ka trajtuar një varg problemesh të letërsisë arbëreshe të Rilindjes.

Krijimtaria e shkrimtarëve arbëreshë u ndriçua në mënyrë të plotë nga ana shkencore vetëm pas çlirimit. Studjuesit tanë hetuan dhe zgjidhën shumë çështje të parrahura ose të trajtuara pjesërisht nga vepra e J. de Radës, G. Darës (i Riu), Z. Serembes, A. Santorit etj. Merita e shkencës sonë për letërsinë është se u dha në dorë lexuesve të sotëm veprat më të shquara të letërsisë arbëreshe, të adaptuara edhe në gjuhën e sotme e të shoqëruara me komente historike dhe letrare.

Por edhe në studimin e trashëgimisë letrare të arbëreshëve të Italisë u shprehën ato të meta, që vumë në dukje më sipër në lidhje me letërsinë artistike, që u zhvilluan në Shqipëri gjatë Rilindjes kombëtare. Kështu, në disa artikuj kushtuar De Radës nuk bëhet fjalë për luhatjet e shkrimtarit, për iluzionet politike që pati ai lidhur me rrugët e sigurimit të lirisë dhe të pavarësisë së Italisë së Jugut. Siç dihet, pas vitit 1848, De Rada largohet nga lëvizja demokratike popullore kundër tiranisë së Burbonëve, me të cilën ishte lidhur në vitet e rinisë së vet. Kjo u shoqërua me thellimin e kontradiktave në botëkuptimin e tij e për pasojë me një farë ftohjeje ndaj ideve të iluministëve francezë, të Volterit dhe të Rusoit. Disa studjues (Dh. S. Shuteriqi etj.) e kalojnë shpejt këtë fakt, duke mos dashur të shohin në të një element me rëndësi për të kuptuar më mirë edhe idetë e disa veprave të poetit. Largimin e De Radës ata e reduktojnë në çështjen e mosmarrëveshjeve që paska pasur shkrimtari me bashkëlufëtaret e tjerë për punë të taktikës dhe të formave të luftës⁹. Kurse A. Varfi, duke e idealizuar figurën e De Radës, nxjerr si shkak të largimit nga lëvizja revolucionare pozitën radikale të poetit, i cili shkon më tej se pjesëmarrësit e tjerë në kërkesat e tij politike. Sipas këtij autori, De Rada demokrat radikal me kohë shkoi kaq përpara, sa pas bashkimit të Italisë i «kapërxen edhe kërkesat e shtresave të varfëra e të mesme fshatare, duke përfshirë çështjet më themelore për ndërtimin e një shteti me të vërtetë popullor»¹⁰.

Krijimtaria e De Radës nuk mund të kuptohet dhe të shpjegohet drejt pa sqaruar mirë etapat e zhvillimit ideor, pozitave e tij në lëvizjen çlirimtare e antifeudale në periudha të ndryshme, në lidhje të ngushtë me elementet kontradiktore në botëkuptimin e tij. Mossqarimi i këtyre çështjeve

9) Dh. S. Shuteriqi, *Në 150-vjetorin e lindjes së Jeronim de Radës*, Nëndori, 1965, Nr. 1, f. 163.

10) A. Varfi, *Rreth ideve politike-shoqërore të J. De Radës* — Shih në përmbledhjen: *Jeronim de Rada* (me rastin e 150-vjetorit të lindjes), Tiranë, 1965, f. 93.

ka çuar në idealizimin dhe madje edhe në modernizimin e figurës së shkrimtarit të madh arbëresh.

Prirja për zbulim është shfaqur edhe në vlerësimin që i është bërë A. Santorit, vepra e të cilit trajtohet jashtë pikëpamjeve konservatore shoqërore e politike, që gjetën shprehje në iluzionin e tij kundrejt kushtetutës, që mbreti Ferdinand i Napolit u shtrëngua të jepte më 1848, i trembur prej lëvizjes popullore (poema «Vallja e Haresë së madhe») dhe karakterizimit jo të drejtë të cubave në dramën «Emira».

Vlerësimet e njëanshme dhe të gabuara të vërejtura në disa studime historiko-letrare e kanë burimin në faktin se analiza e veprave të shkrimtarit nuk lidhet sa duhet me botëkuptimin, me pozitën ideore në këtë ose atë periudhë të veprimtarisë së tij. Në punimet e ardhshme i duhet kushtuar shumë më tepër vëmendje studimit të veçorive konkrete dhe ligjëshmore të botëkuptimit të shkrimtarit, të cilat janë forca lëvizëse e punës së tij krijuese dhe mbi bazën e të cilave ata arrijnë në përgjithësim të rëndësishme artistike. Duke u mbështetur në një njohje të gjërë e të thellë të pikëpamjeve ideologjike të shkrimtarëve, studjuesit e historisë së letërsisë duhet të zbulojnë anët përparimtare të krijimtarisë së tyre, të vënë në dukje elementet demoraktike progresive dhe në të njëjtën kohë të kritikojnë kufizimet ideore dhe klasore, ildhur ngushtë me shkaqet që i kanë përcaktuar.

* * *

Për të kuptuar drejt si rolin dhe vendin e një shkrimtari në historinë e letërsisë, ashtu edhe kufizimet e tij ideore artistike është e domosdoshme të kihet një përfytyrim i thellë dhe i gjithanshëm mbi procesin historiko-letrar, mbi tendencat e tij kontradiktore. Në literaturën shkencore dhe mësimore flitet shkarazi, se përveç letërsisë patriotike në periudhën e Rilindjes kombëtare ekzistonin edhe rryma të tjera, por kjo mbetet si diçka e veçuar, e palidhur në mënyrë organike me kuadrin e përgjithshëm historiko-shoqëror dhe rrymat e ndryshme ideore të epokës. Dhe kjo vjen, sepse në konceptin mbi zhvillimin e letërsisë shqipe në periudhën e Rilindjes të pranuar nga shkenca jonë, ka aspekte, të cilat duhen sqaruar dhe përpunuar më tej.

Më të shumtën e herës për rrymat dhe drejtimet e ndryshme të letërsisë së Rilindjes në studimet dhe në diskutimet e ndryshme është folur duke pasur më tepër parasysh luftën politike që është zhvilluar në shtyp, se sa pasqyrimin e saj në vetë krijimtarinë letraro-artistike. Një gjë e tillë ka çuar në përzjerjen e dy fushave studimi: të historisë së mendimit politiko-shoqëror me historinë e letërsisë. Kjo rrethanë këtej e tutje duhet pasur fort parasysh, sepse jo rrallë midis lëvizjes politiko-shoqërore dhe letërsisë artistike, të përfutuar prej saj, është vënë shenjë barazimi. Kur flasim për letërsinë artistike të Rilindjes, s'duhet të harrojmë për asnjë çast, se sadoqë lindja e saj u përcaktua nga ndryshimet që ndodhën në lëvizjen çlirimtare kundër pushtuesve turq në mesin e shekullit të kaluar, ajo u zhvillua në përputhje me ligjëshmëritë e veta specifike si formë e veçantë e vetëdijes shoqërore. Sigurisht rrethanat historike dhe rrymat politiko-shoqërore, që gjetën pasqyrim kryesisht në shtyp, luajtën rol të madh në zhvillimin e letërsisë, por ndikimi i këtyre faktorëve shprehet në të në formë origjinale, në përputhje me veçoritë e saj si fushë specifike e vetëdijes shoqërore.

Në lëmin e studimeve historiko-letrare del si detyrë e ngutshme përpunimi i një koncepti tërësor dhe koherent mbi zhvillimin e letërsisë shqipe lidhur ngushtë me tendencat kontradiktore që janë shfaqur në gjirin e saj. Për këtë qëllim është e domosdoshme të sqarohen kushtet e formimit dhe të zhvillimit të rrymave të ndryshme në letërsinë shqipe, gjeneza klasore e rrymave ideore që i kanë përfutur ato, problemi i vendit që zënë dhe i rolit që kanë lujtur në historinë e letërsisë shqipe dhe në historinë e shoqërisë shqiptare.

Në punimet, në artikujt dhe në tekstet mbi letërsinë e Rilindjes kombëtare, problemi i pasqyrimin të luftës së klasave në procesin historiko-letrar dhe në lidhje me këtë problemi i rrymave letrare, vetëm sa është cekur. Por pa sqarimin e këtij problemi nuk mund të formojmë një përfytyrim të saktë dhe të plotë mbi vetë ligjëshmëritë e zhvillimit të letërsisë shqipe në këtë periudhë, mbi tendencat dhe fenomenet kontradiktore që e shoqëruan këtë letërsi.

Siç dihet, në fazën e parë të Rilindjes nuk viheshin re dallime të dukshme në drejtimin ideor të veprimtarisë së aktivistëve të shquar të lëvizjes kombëtare, që luftonin për zhvillimin e arësimit, për lavrimin e gjuhës amtare dhe për formimin e shtetit kombëtar shqiptar. Kjo u shpreh edhe në përmbajtjen e veprave letrare, të cilat hymnizonin virtutet heroike të shqiptarëve ndër shekuj, ngrinin lart bukurinë e gjuhës shqipe, i këndonin dashurisë për atdheun. Fryma e përgjithshme patriotike karakterizon krijimtarinë e N. Frashërit, vjershat e P. Vasës, F. Shirokës, S. Dines, vjershat dhe shkrimet në prozë të P.K. Negovanit etj. Por, duke u nisur nga fillimi i shek. XX në letërsinë shqipe shfaqen prirje të reja, që pasqyrojnë diferencimin që po ngjiste në lëvizjen patriotike, diferencim që nga ana e vet ishte shprehje e synimeve politike të grupeve dhe të forcave të ndryshme shoqërore brenda lëvizjes.

Me ardhjen në lëvizjen kombëtare në kapërcyellin e shek. XIX dhe XX të elementëve nga radhët e inteligjencës demokratike borgjeze (A.Z. Çajupi) dhe të intelektualëve demokratë mikroborgjezë (Asdreni, M. Grameno, F.S. Noli, S. Nivica etj.), në letërsi forcohen prirjet anti-feudale çlirimtare. Këto ndryshime i shohim në veprën e Çajupit, i cili shprehu synimet e shtresave të gjera demokrate për t'i dhënë fund bashkë me tiraninë osmane edhe sundimit të feudalëve të urryer që ishin gjithashtu përgjegjës për gjendjen e mjeruar në të cilën ishte kredhur vendi. Të njëjtën gjë e shohim edhe në veprën e Asdrenit, Gramenos etj. Për këta shkrimtarë ishte karakteristik demokratizimi, fryma anti-feudale militante, patriotizmi popullor. Në krijimet e tyre ata pasqyruan interesat e vegjëlisë, të fshatarëve, zanatçinjve, kurbetlinjve dhe tregtarëve, botën e mendimeve dhe ndjenjave të njerëzve të thjeshtë të popullit, dashurinë e tyre të singertë për atdheun, përbuzjen dhe urrejtjen që kishin për klasat e pasura, të cilat nuk e vrisnin mendjen për çështjen e çlirimit kombëtar, aspiratën e tyre të flaktë për drejtësi shoqërore.

Në punimet e deritanishme përmbajtja demokratike e veprave të këtyre shkrimtarëve nuk është vënë në pah në mënyrë të plotë e të qartë. Është folur për motivet e reja që duken në këtë kohë, por kjo është bërë në mënyrë sporadike dhe nuk është lidhur me rrugën e letërsisë shqipe, me ndryshimet cilësore që ndodhën në të në fillim të shekullit. Ndonjëherë këta shkrimtarë janë studjuar vetëm në planin patriotik dhe nuk është zbuluar ajo që është kryesore dhe karakteristike në veprën e tyre — fryma demokratike. Kështu, në studimet kushtuar Asdrenit, poeti, i cili në mënyrë më të hapur dhe më tepër se kushdo tjetër shpre-

hu dëshirat më të shtrenjta të vegjëlisë, që ëndërronte të shpëtonte nga dhuna dhe arbitrariteti i të fuqishmëve, përshkruhet si vazhdues i thjeshtë i tematikës patriotike të N. Frashërit. «Para së gjithash, — lexojmë në një punim, — Asdreni si vazhdues i Rilindjes është një poet i atdheut. Njësoj si Naimi edhe Asdreni i vuri që në fillim vetes një mision të lartë patriotik». ¹¹

Pa i zmadhuar dhe zbkuruar gjërat, këtu del nevoja që të nxirret në shesh në mënyrë më të plotë përmbajtja demokratike e letërsisë së Rilindjes kombëtare, të tregohet si në procesin e diferencimit të mëtejshëm në gjirin e forcave të lëvizjes çlirimtare, letërsia shqipe u afrua për herë e më shumë në jetën e masave popullore dhe kjo çoi më në fund në formimin e letërsisë demokratike, si letërsi e lëvizjes së gjerë demokratike, për vendosjen në Shqipëri të një regjimi politik e shoqëror të përparuar.

Krahas kësaj, shkencës sonë për letërsinë, i bie detyra të studiojë luftën që është zhvilluar midis letërsisë patriotike e demokratike dhe letërsisë antipërparimtare, rrugën e formimit të letërsisë demokratike si kundërpeshë ndaj letërsisë borgjeze dhe ndaj letërsisë klerikale katolike në kuadrin e luftës së përgjithshme të shtresave demokratike kundër forcave konservatore dhe reaksionare gjatë Rilindjes kombëtare dhe veçanërisht në vitet 20-30, për zhvillimin e vendit në rrugën demokratike dhe të përparimit shoqëror.

Dihet, se nga mesi i shek. XIX kisha katolike nisi ta merrte veten nga sulmet dhe dëmet e mëdha që i kishte shkaktuar Turqia. Një ndihmë të madhe për këtë dha Austria, e cila synonte që ta përdorte klerin katolik për qëllimet e veta politike në Shqipëri. Në fund të shekullit të kaluar priftërinjtë katolikë nisin të tregojnë interesim për lëvizjen kombëtare dhe, natyrisht, të nisur nga interesat e kishës katolike, dalin me botime, bashkëpunojnë në organet e ndryshme të kohës, si në revistën «Albania» të F. Konicës e gjetkë, organizojnë shoqëri kulturele, ndërhyjnë aktivisht edhe në ngjarjet politike të kohës. Nga fillimi i shek. XX veprimtaria e tyre në fushën politike dhe kulturele bëhet përherë e më aktive; kleri katolik në mënyrë gjithnjë e më të hapur e të përcaktuar shpallte të drejtën e vet që të kishte peshë në zgjidhjen e problemeve themelore të popullit shqiptar.

Me lëvizjen klerikale katolike në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX është e lidhur krijimtaria e Gj. Fishtës, V. Prenushit, A. Harapit etj., e cila synonte në forcimin e ndikimit ideologjik e politik të kishës katolike në Shqipëri. Përmbajtja kryesore e veprave të shkrimtarëve klerikalë katolikë ishte idealizimi i anëve më reaksionare të rendit fisnor-patriarkal të malësisë, si të kanunit, bajraktarizmit, fanatizmit fetar dhe injorancës, të cilat i paraqisnin si vlerat më të çmuara shpirtërore të kombit, si tipare karakteristike kombëtare të shqiptarëve. Në përputhje me programin e vet politik këta autorë bënë çmos për të penguar futjen e parimeve dhe formave të reja të jetës dhe iu bënë gardh çdo prirje për ndryshime shoqërore.

Përveç letërsisë klerikale katolike, nga fillimi i shek. XX, nxjerr kryet edhe një letërsi «apolitike», antipopullore në thelb, e cila u përfaqësua nga Mit'hat Frashëri dhe F. Konica. Veçoritë karakteristike të

11) Asdreni, *Vepra të zgjedhura*. Mbledhur e redaktuar prej Dh. Fullanit, Tiranë, 1958, f. 9.

veprave të këtyre shkrimtarëve, në të cilat u shpreh qëndrimi i huaj i klasës feudale dhe i shtresave konservatore borgjeze kundrejt problemeve të mëdha të vendit, ishin këmbëngulja për të mos u bërë jehonë shqetësimeve të lëvizjes popullore për çlirim kombëtar, individualizmi, estetizmi, formalizmi dhe etnografizmi i ngushtë.

Është e kuptueshme se pa njohur këto rryma letrare nuk mund të formohet një përfytyrim i fortë dhe i drejtë mbi procesin historiko-letrar në këtë periudhë, mbi luftën e klasave që është zhvilluar në letërsi dhe mbi rrugën e formimit të letërsisë demokratike.

* * *

Nga e kaluara, në lëmin e studimit të letërsisë së viteve '20-30', nuk u trashëguan veçse disa recensione dhe kritika të shkurtëra. Shkenca e sotme ka meritën që e vuri studimin e kësaj periudhe të rëndësishme të historisë së letërsisë kombëtare mbi baza shkencore. Pa përmendur krijimtarinë e shkrimtarëve demokratë më të shquar të kësaj epoke, Nolit dhe Migjenit, u studjua vepra e një vargu autorësh të rinj, të cilët hynë në jetën letrare në vitet '30, u hulumtua lufta letrare e kohës, gjinitë dhe llojet që lëvruan shkrimtarët përparimtarë etj.

Megjithatë nuk është vendosur ende një koncept i vetëm mbi zhvillimin historik të letërsisë në këtë periudhë. Disa studjues, duke mos kuptuar përmbajtjen e kësaj periudhe në historinë e vendit, karakterin e luftës shoqërore, u prirën ta shihnin letërsinë demokratike të kësaj periudhe si letërsi socialiste. Kështu, M. Gurakuqi mendon se letërsia përparimtare e viteve '20-'30 «nga demokratike e përparimare në përgjithësi fillon e kalon në një stad më të përparuem e nis e merr konturet e një letërsie me tendenca socialiste». ¹² Kurse R. Brahimi shkon më tej; për të problemi i letrarëve të rinj të viteve '30 s'mund të ish veçse një letërsi e realizmit socialist ¹³. Në përputhje me këtë koncept F.S. Noli me Migjenin u vizatuan si poetë socialistë, ose përfaqësues të realizmit socialist. S'ka dyshim, se e gjithë kjo bie në kundërshtim me faktet.

Çështja mbi karakterin dhe frymën ideore të letërsisë shqipe të viteve '20-'30 mund të zgjidhet drejt vetëm duke u nisur nga një përfytyrim i saktë mbi kushtet historiko-shoqërore të Shqipërisë në këtë periudhë.

Rrethanat e veçanta të zhvillimit historik, si prapambetja e theksuar ekonomiko-shoqërore e vendit, dobësia e klasës së re borgjeze, fakti që lëvizja spontane e fshatarësisë kundër shfrytëzimit feudal nuk u shkri në një me lëvizjen politike të aktivistëve të Rilindjes, përkrahja që shtetet e huaja i jepnin klasës feudale, bënë që lufta për çlirim kombëtar të mos çojë në likuidimin e sistemit të marrëdhënjeve të vjetra ekonomike dhe shoqërore. «Kishte kohë, — ka thënë shoku Enver Hoxha, — që kushtet e zhvillimit të prodhimit në vendin tonë shtonin në rendin e ditës revolucionin demokratiko-borgjez, likuidimin e marrëdhënjeve feudale në prodhim që binin në kundërshtim me karak-

12) Shih: *Çështje të tematikës dhe të zhvillimit të realizmit në letërsinë tonë përparimtare të viteve '30*, në librin «Autorë dhe probleme të viteve '30». Tiranë, 1966, f. 22.

13) Shih: *Fillimet e letërsisë sonë të realizmit socialist* në librin «Shënime letrare». Tiranë, 1965, f. 14.

terin e forcave prodhuese dhe vendosjen e marrëdhënjeve të reja kapitaliste në prodhim, por që do t'u hapnin rrugë zhvillimi forcave prodhuese të vendit». ¹⁴ Më 1924 u bë përpjekja e parë për t'i zgjidhur këto detyra me anë të rrugës revolucionare, por për shkak të mungesës së udhëheqjes së drejtë dhe të vendosur si dhe të ndërhyrjes së reaksionit ballkanik dhe evropian, revolucioni demokratiko-borgjez i qershorit të atij viti dështoi. Megjithatë zgjidhja e detyrave që shtroi ai, mbeti në rendin e ditës gjatë gjithë periudhës së mëvonshme.

Letërsia përparimtare shqipe e viteve '20-'30 shprehu interesat dhe idealet e lëvizjes së përgjithshme popullore për transformime të thella demokratike në jetën e vendit.

Patosi kryesor i veprës së njërit nga përfaqësuesit më të shquar të kësaj letërsie, F.S. Nolit, ishte lufta kundër forcave të vjetra shoqërore, në radhë të parë kundër feudalëve, të cilët ishin bërë pengesë për kalimin e vendit në udhën e zhvillimit demokratik dhe të përparimit shoqëror. Në poezinë e tij politike stigmatizohen përfaqësuesit e reaksionit, të cilët u orvatën të ruanin format e organizimit të jetës shtetërore e shoqërore të trashëguara nga Turqia. Pas qershorit të 1924-ës Noli e vijoi demaskimin e klasave reaksionare; në këtë kohë ai formoi bindjen se vetëm kryengritja e përgjithshme do të mund të përmbyste tiraninë e urreyer çifligaro-borgjeze («Anës lumenjve»).

Autori tjetër i shquar i letërsisë demokratike të viteve '20-'30, Migjeni, e drejtoi vëmendjen në padrejtësinë e madhe shoqërore që mbizotëronte në kohën e tij, në rrojtjen tragjike të masave të varfëra të qytetit dhe të fshatit, në pasojat shkatërruese të rendit çifligaro-borgjez, i cili përdhoste dhe prishte çdo gjë pozitive të njerëzisë dhe thjeshtë, duke i shtyrë këta në rrugën e lypësisë, të vjedhjes dhe të prostitucionit.

Demaskimi i thelbit antipopullor të rendit ekzistues, i shtypjes dhe i shfrytëzimit të vegjëlisë, kritika e marrëdhënjeve feudale-borgjeze, simpatia për masat e shfrytëzuara formon brendinë edhe të veprës së shkrimtarëve të rinj përparimtarë, që hynë në jetën letrare në vitet '30, si të A. Çaçit, Sh. Musarajt, P. Markos, Dh. S. Shuteriqit, V. Varfit etj.

Përveç këtyre shkrimtarëve, të cilët përmes veprës së tyre bënë objekt të kritikës së vet pabarazinë shoqërore kundrejt masave të popullit, në letërsinë përparimtare të viteve '20-'30 pati dhe autorë, si H. Stërmilli, të cilët u ngritën kundër despotizmit dhe fanatizmit në jetën familjare e shoqërore, kundër zakoneve prapanike dhe mizore, që pengonin zhvillimin e lirë të personalitetit të njeriut. Asokohe kritika e formave të vjetëruara dhe anakronike të jetës shoqërore e familjare ishte një veprim progresiv, sepse tërthorazi ajo ishte një fshikullim i institucioneve reaksionare, që pengonin emancipimin shpirtëror të njerëzve të thjeshtë.

Me gjithë synimin romantik drejt një të ardhmeje të lumtur dhe aluzionet e mjegullta për ndryshimin e gjendjes që gjejmë te Migjeni dhe te disa poetë të rinj të kohës, ky prodhim letrar nuk del jashtë kuadrin të një letërsie demokratike. Nga fryma dhe idealet shoqërore që e frymëzonin, letërsia e viteve '20-'30 në thelb ishte një letërsi demokratike, e lidhur ngushtë me ideologjinë dhe kulturën demokratike të kohës. Trualli historiko-shoqëror mbi të cilin lindi kjo letërsi

¹⁴ E. Hoxha, *Raport mbajtur në Kongresin III të Frontit demokratik të Shqipërisë*, Tiranë, 1955, f. 6.

ishte lëvizja e masave popullore kundër sistemit çifligaro-borgjez, kundër arbitraritetit të administratës së kalbur shtetërore, kundër parimeve dhe formave prapanike të jetës, kundër politikës antikombëtare të nënshtrimit ndaj imperializmit italian.

Në lëmin e letërsisë së viteve '20-'30 studjuesve u del detyra që të njohin mirë përmbajtjen e kësaj periudhe historike, luftën shoqërore, rrymat e ndryshme ideore të kohës dhe ta vendosin studimin e saj mbi një bazë sa më të shëndoshë shkencore.

Mospërfillja e parimit të historizimit dhe e saktësisë shkencore në paraqitjen e procesit të zhvillimit letrar në vitet '20-'30, që është shprehur në orvatjet për t'i modernizuar këta autorë, për t'i paraqitur sa më afër kohës sonë nga pikëpamja ideore, dëmton hulumtimin objektiv e të thellë të kësaj periudhe letrare dhe formimin e një koncepti të drejtë shkencor mbi të.

* * *

Ka kaluar një çerek shekulli që prej ngadhnjimit të revolucionit popullor. Kjo periudhë është e mbushur plot me ngjarje madhështore në jetën e vendit tonë. Gjatë këtyre njëzet e pesë vjetve është krijuar një letërsi e tërë me cilësi të reja ideologjike e artistike, e cila lot një rol të rëndësishëm në ndërtimin e shoqërisë socialiste në Shqipëri. Kjo letërsi nuk është bërë ende objekt i studimit të kujdesshëm dhe të thelluar shkencor; në fushën e studimeve tona letrare ka ekzistuar një interesim i tepëruar ndaj letërsisë shqipe të periudhave të kaluara, së cilës i janë kushtuar deri më sot më e shumta e studimeve tona historiko-letrare. Pa dyshim, trashëgimi ynë më progresiv në lëmin e letërsisë duhet njohur mirë dhe studjuar me kujdes; pa këtë ajo nuk mund të përvetësohet në mënyrë kritike dhe nuk mund të vihet në shërbim të kulturës së re socialiste. Por krahas kësaj duhet të ndërmerren studime për letërsinë shqipe të realizmit socialist, të njihet ajo në mënyrë sa më të plotë dhe më të thellë. Në fjalën e tij të 7 marsit 1968 shoku Enver Hoxha vuri në dukje rëndësinë e madhe që ka në kushtet e sotme njohja e letërsisë së realizmit socialist. «... Duhet luftuar çdo nënvleftësim që i bëhet letërsisë së periudhës së pushtetit popullor. Kësaj letërsie, duhet t'i hapen mirë dyert e shkollës, sepse në të pasqyrohen ndjenjat dhe përpjekjet e një epike të re të lavdishme dhe është e tillë që mund e duhet të shërbejë për edukimin e gjithanshëm të masave me idealet e larta të shoqërisë socialiste e komuniste»¹⁵. Në këtë fjalë studjuesit e letërsisë duhet të shohin edhe kritikën drejtuar punës së tyre.

Sot shtrohet si detyrë e ngutshme që të organizohet studimi shkencor i thelluar dhe i organizuar i letërsisë shqipe të realizmit socialist. Një nga problemet e rëndësishme në këtë fushë është ai i gjenezës dhe i lindjes së realizmit socialist në Shqipëri. Rreth këtij problemi janë shkruar disa artikuj e shënime dhe mund të themi se është problemi historiko-letrar më i diskutuar. Megjithatë ai ende nuk është zgjidhur përfundimisht. Për të sqaruar procesin e lindjes dhe të formimit të realizmit socialist, është e domosdoshme që të hetohet në mënyrë të

15) E. Hoxha, *Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë*, Tiranë, 1968, f. 37.

plotë problemi i premisave të tij historiko-shoqërore dhe historiko-letërore, të dalë qartë se si zhvillimi historik dhe letrar në Shqipëri solli në lindjen e artit të realizmit socialist, si kontribuan në këtë drejtim traditat progresive të artit kombëtar të së kaluarës. «Letërsia, arti, kultura jonë socialiste, — ka thënë shoku Enver Hoxha, — nuk kanë lindur në një vend të zbrazët, por mbi bazën e zhvillimit të gjatë historik të shoqërisë sonë, të jetës së saj shpirtërore, të traditave të shquara e më të mira kulturalo-artistike të popullit».¹⁶

Mbi bazën e zgjidhjes së këtyre çështjeve del detyra që të sqarohet vetë procesi i formimit të metodës së re krijuese në letërsinë e sotme shqipe, dmth. i parimit realist sipas të cilit shkrimtarët zgjedhin, tipizojnë dhe vlerësojnë në pikëpamje emocionale ngjarjet nga pozitat e socializmit shkencor, i parimit që siguron pohimin realist të jetës. Pa dyshim, se ky parim nuk zuri vend menjëherë në veprimtarinë krijuese letrare; u desh një farë kohe, disa vjet, gjatë të cilave shkrimtarët përvetësuan kuptimin konkret-historik, konsekuent të ligjëshmërive të zhvillimit shoqëror, i cili siguron që karakteret tipike të pasqyrohen në mënyrë besnike jo vetëm në rrethanat tipike të formuara realisht prej kohësh, por edhe në perspektivat e zhvillimit të tyre.

Problem tjetër i rëndësishëm, që qëndron përpara studjuesve të letërsisë, është studimi i etapave që ka kaluar letërsia e realizmit socialist që nga lindja e deri në ditët tona, përcaktimi i veçorive karakteristike dhe i ligjëshmërive të çdo etape. Sidomos, duhet të sqarohet se çfarë dha çdo etapë në pasurimin e letërsisë, si u shfaqën dhe u kristalizuan cilësitë e reja, si u zgjidhën në etapa të ndryshme problemet themelore letrare, si problemi i pasqyrimin të heroit të ri, të lindur dhe të kalitur në procesin e luftës revolucionare për ndërtimin e shoqërisë së re, problemi i pasqyrimin të popullit si faktor themelor i zhvillimit historik etj. Për këto probleme duhen shkruar studime dhe monografi të posaçme, në të cilat të përgjithësohet përvoja e letërsisë sonë të realizmit socialist, fryma e saj optimiste pohuese, ideshmëria komuniste dhe partishmëria proletare luftarake që e shquan. Sqarimi i këtyre problemeve shkencore është i lidhur ngushtë me studimin e rolit të madh që ka luajtur Partia e Punës në formimin dhe zhvillimin e letërsisë sonë, e ndihmës së çmueshme që ka dhënë ajo, duke u hapur horizontin shkrimtarëve, duke i orientuar në ngjarjet dhe në proceset e mëdha të jetës së vendit dhe duke i përkrahur vazhdimisht në luftën për krijimin e artit socialist.

Lexuesve tanë, mësuesve të letërsisë dhe të gjithë atyre që interesohen për letërsinë e sotme, u duhen punime dhe monografi mbi shkrimtarët tanë kryesorë, mbi zhvillimin e gjinive të ndryshme, të prozës, të poezisë dhe të dramës, mbi romanin e sotëm shqiptar, i cili ka arritur një varg suksesesh dhe ka dalë në krye të llojeve të tjera letrare, mbi larinë që ka fituar poezia dhe sidomos lirika këto vitet e fundit etj. Studime dhe artikuj shkencorë duhet të shkruhen edhe për veprat artistike, që përfaqësojnë sukseset më të shquara të letërsisë sonë të sotme.

Para shkencës sonë për letërsinë del detyra që të përgjithësojë përvojën e deritanishme të letërsisë së realizmit socialist dhe të merret me çështjet e zhvillimit të sotëm letrar. Rëndësi të veçantë ka studimi i tipareve origjinale të periudhës aktuale të zhvillimit të letërsisë së

16) E. Hoxha, *Raport i mbajtur në Kongresin V të PPSH, Tiranë, 1968, f. 140.*

realizmit socialist. Revolucionarizimi i mëtejshëm i vendit ka nxjerrë përpara shkrimtarëve tanë detyra të reja të ndërlikuara. Periudha pas Letrës historike të KQ drejtuar popullit dhe veçanërisht pas Kongresit V të partisë, karakterizohet nga një luftë e madhe që po bëjnë klasa punëtore dhe masat punonjëse me partinë në krye, për të siguruar zhvillimin e pandërprerë të revolucionit socialist në të gjitha fushat e jetës. Idetë e dokumentave të partisë kanë shkaktuar një gjallërim të paparë të jetës shoqërore, një shpërthim të vrullshëm të energjive krijuese të masave punonjëse, të cilat s'ka ditë të mos japin shembuj të një qëndrimi revolucionar në jetë dhe në punë. Të gjitha këto dëshmojnë për rritjen e mrekullueshme të vetëdijes së njerëzve, të ndjenjës vetjake, të përgjegjësisë për të çrrënjësuar shfaqjet negative që përmbajnë në vetvete farën e degjenerimit borgjez e revizionist. Ngjarjet e reja në jetë kanë nisur të pasqyrohen ndër veprat letrare. Studjuesve të letërsisë u duhet të hetojnë e të përcaktojnë ato tipare, kontradikta dhe konflikte specifike, paraqitja e të cilave është karakteristike për veprat e sotme letrare dhe që ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga materiali i letërsisë sonë të periudhave të mëparshme.

Duke u mbështetur në njohjen e thellë të proceseve të reja, që po zhvillohen në jetën e shoqërisë sonë, historianët dhe kritikët letrarë duhet të përkrahin ata shkrimtarë, të cilët shtrojnë probleme të mprehta dhe të rëndësishme, për të cilat nuk ka dhënë ende përgjigje vetë jeta, të tregojnë se çfarë aspekte kanë mbetur ende pa u ndriçuar dhe ç'probleme duhet të tërheqin vëmendjen e letrarëve.

Zhvillimi aktual i letërsisë shtron nevojën e përpunimit të mëtejshëm të disa problemeve themelore të krijimtarisë letrare, si problemin e lidhjes së letërsisë me jetën e popullit, të rritjes së rolit edukativ revolucionar të veprave artistike, të heroit të ri, që ka nisur të formohet në zjarrin e luftës për thellimin e mëtejshëm të revolucionit socialist, të forcimit të karakterit tendencioz klasor, të krijimtarisë letrare, problemi i formës dhe i brendisë kombëtare etj. Studjuesit dhe kritikët letrarë duhet të merren me këto probleme, duke i ndriçuar kështu rrugët e zhvillimit të mëtejshëm të letërsisë shqipe të realizmit socialist.

Shkenca dhe kritika jonë letrare duhet të luftojnë që shkrimtarët të ngrajnë nivelin e punës së tyre krijuese, t'i kushtojnë më shumë kujdes formës së krijimeve letrare, të luftojnë për të përvetësuar të gjithë përvojën pozitive të letërsisë sonë përparimtare të pasqirimit dhe të autorëve të mëdhenj progresivë të letërsisë botërore.

Duke qenë sektor i rëndësishëm i frontit ideologjik, shkenca për letërsinë, nuk mund të qëndrojë indiferente kundrejt luftës që zhvillohet sot midis marksizëm-leninizmit dhe ideologjisë armike. «... Tani — ka thënë shoku Enver Hoxha, — që shumë probleme urgjente të zhvillimit në gjerësi të revolucionit kultural janë venë në rrugën e zgjidhjes, krijohen mundësi për t'u thelluar akoma më shumë në forcimin e cilësisë dhe të përmbajtjes komuniste të gjithë punës arësimore e kulturele. Nga kjo pikëpamje tani në lëmin e zhvillimit të kulturës socialiste shtrohen detyra të reja që kanë të bëjnë me nevojën e një lufte të vendosur kundër ndikimeve të huaja dhe traditave borgjeze e revizioniste, me nevojën e krijimit të kulturës së vërtetë socialiste në shërbim të plotë të politikës proletare dhe të përshkuar nga ideologjia marksiste-leniniste». ¹⁷

17) *Po aty*, f. 135.

Ashtu si punonjësve të shkencave të tjera shoqërore edhe studjuesve të letërsisë dhe kritikëve letrarë u bie barra që të luftojnë në mënyrë aktive dhe me konsekuencë më të madhe parimore kundër shkencës borgjeze, revizionizmit dhe të gjitha shfaqjeve të ndryshme të idealizmit.

Duke zbuluar rrënjët e idealizimit dhe zbukurimit të shkrimtarëve të së kaluarës, shoku Enver Hoxha ka thënë: «Në këtë çështje pasqyrohen pikëpamjet filozofike të shkollave borgjeze, simpatitë individuale të njerit ose të tjetrit sipas prirjes dhe sipas shkollës dhe kulturës me të cilën ai është mbrujtur dhe që nuk ka arritur dot akoma të spastrojë rrënjësisht «hauret e Ozhiasit».¹⁸

Shkenca jonë për letërsinë u rrit në luftë kundër koncepteve të metodës esteto-formaliste dhe të shkollës historiko-kulturale. Por, me sa duket, mbeturinat e këtyre koncepteve në një mënyrë ose në një tjetër hasen edhe sot. Pikërisht në ato e kanë burimin gabimet dhe të metat e vërejtura në trajtimin e problemeve të trashëgimit kultural, trajtimet dhe vlerësimet subjektivistike dhe të njëanshme për një varg çështjesh të letërsisë shqipe të së kaluarës. Kështu p.sh. në prirjen për të fshehur luhatejt ideore të shkrimtarëve përparimtarë të Rilindjes, kontradiktat në botëkuptimin dhe veprën e tyre, pa dyshim, ka gjetur pasqyrim teoria borgjeze, e cila e sheh letërsinë si diçka që zhvillohet jashtë jetës shoqërore, si diçka organike dhe tërësore, pa kontraste dhe antagonizma.

Si shfaqje e ndikimit të metodës formaliste duhet parë edhe prirja për të vënë theksin më tepër në anën formale të veprës se sa në analizën e brendisë ideore, prirja për t'u marrë më shumë me çështjet e vargut, të mjeteve shprehëse të gjuhës etj. «Në ideologji nuk mund t'i bëjnë koncesion vargut ose gjuhës»,¹⁹ — ka thënë shoku Enver Hoxha, — duke pasur parasysh ato vepra, në të cilat shqyrtim i tepruar i mjeteve stilistike ka bërë që të heshtej për cenet e dobësitë e veprës në pikëpamje të idesë.

Luftën e tyre kundër koncepteve dhe teorive borgjeze e revizioniste studjuesit dhe kritikët tanë letrarë duhet ta zhvillojnë sidomos në lëmin e letërsisë së sotme. Dihet, se vitët e fundit kanë dalë një varg veprash, si «Tuneli», «Dueli», «Rrethimi i bardhë», «Përbindëshi», «Drama e një partizani pa emër» etj., të cilat dëshmojnë se disa shkrimtarë kishin rënë pre e koncepteve të huaja, «e realizmit të thelluar», «e artit objektiv» etj., që janë shumë në modë sot ndër revizionistët. Në rrethanat e tanishme, kur letërsitë e vendeve revizioniste po kridhen gjithnjë e më thellë në llumin e degjenerimit borgjez, del detyra aktuale e mbrojtjes së parimit të partishmërisë komuniste, e frymës optimiste pohuese dhe e karakterit heroik të realizmit socialist. Në luftë kundër teoricienëve dhe kundër shkrimtarëve revizionistë jo vetëm duhet mbajtur lart flamuri i realizmit socialist, por duhen përpunuar dhe zhvilluar më tej parimet ideore dhe estetike të artit revolucionar proletar.

Që të mund të zgjidhë detyrat e reja që shtrou thellimi i mëtejshëm i revolucionit ideologjik e kultural, shkenca për letërsinë duhet të forcohet në pikëpamje teorike. Gabimet dhe dobësitë në studimet historiko-letrare dhe në tekstet e kanë burimin edhe në zotërimin e pamjaftueshëm të parimeve të metodologjisë marksiste. Një nga të metat kryesore në

18) E. Hoxha, *Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë*, Tiranë, 1968, f. 3.

19) *Po aty*, f. 36.

këtë drejtim është paqartësia lidhur me parimin e studimit të gjenezës socialo-klasore të letërsisë. Mungesa e një përfytyrimi të qartë përmbi këtë problem ka sjellë si rezultat moszbulimin e lidhjeve të vërteta në mes të veprës së shkrimtarëve dhe të epokës. Më të shumtën e herës roli i kushteve historiko-shoqërore është kuptuar në mënyrë të jashtme, mekanike. Si rregull, para analizës së veprës së një shkrimtari dhe të letërsisë së një periudhe është dhënë një farë sfondi i përgjithshëm, plot të dhëna historike, ekonomike, shoqërore dhe kulturele, renditur njëri pas tjetrit, ndoshta të vlefshme si informacion, por që ndihmojnë pak për të kuptuar rrënjët socialo-klasore të veprës së shkrimtarit dhe ligjëshmëritë e rrugës së tij krijuese në art. Këto karakteristikë të epokës janë kthyer në diçka formale, sepse nuk vendoset drejt raporti midis rrethanave historike konkrete dhe ligjëshmërive të vetë zhvillimit letrar, nuk zbulohet si është pasqyruar ndikimi i realitetit historik në zhvillimin e brendshëm të letërsisë. Ndonjëherë kujtohet se lidhjet e krijimtarisë së shkrimtarit me kohën së cilës i përket, do të dalin qartë vetëm mjafton që të numërohen faktet historike të epokës. Kuadri historik është, pa dyshim, i domosdoshëm, por në mënyrën si është dhënë deri tashti del i pamjaftueshëm. Për të kuptuar thelbin social të krijimtarisë së një shkrimtari, duhet njohur mirë atmosfera ideore e kohës, rrymat e ndryshme ideologjike, që i japin tonin jetës mendore. Siç dihet, klasat shoqërore jo vetëm zhvillojnë luftë në mes tyre, por krijojnë në këtë proces lëvizje të tëra shoqërore, të paisura me koncepte të caktuara ideologjike, të cilat interpretojnë jetën në dritën e idealeve të caktuara shoqërore. Sikur të gjithë pjesëtarët e tjerë të shoqërisë, shkrimtari nuk mbetet jashtë këtyre lëvizjeve të rëndësishme të epokës. Nën ndikimin e luftës ideore e të rrymave të rëndësishme ideore formohen pikëpamjet e tij politike e shoqërore, botëkuptimi i tij, i cili shprehet në përgjithësimet artistike të veprave që shkruan. Vetëm pasi të kemi të qartë se ç'interesa socialo-klasore janë shprehur në rrymën ideologjike, nën ndikimin e së cilës është formuar pozita ideore e shkrimtarit, atëherë do të kuptojmë drejt edhe vlerën objektive ideologjike të veprave të tij. Kështu, duke mos u njohur gjeneza dhe karakteri social i lëvizjes për çlirimin kombëtar në fund të shek. XIX dhe në fillim të këtij shekulli, nuk u hetuan dhe nuk u vunë në pah me qartësi kufizimet ideore e klasore të një vargu përfaqësuesish të letërsisë shqipe të kësaj periudhe, kurse në studimet kushtuar letërsisë së viteve '20-'30 nuk u zbulua ndikimi që ushtroi në të lëvizja demokratike dhe ideologjia e saj.

E metë tjetër e shfaqur në disa punime historiko-letrare është dhe fakti që në to nuk tregohet sa duhet ndikimi i kundërt i letërsisë në jetën e shoqërisë. Shkrimtarët e së kaluarës nuk janë shikuar sa duhet si pjesëmarrës të gjallë; të drejtpërdrejtë të lëvizjes historike dhe vepra e tyre s'është parë gjithnjë edhe si një faktor aktiv në ecjen përpara të shoqërisë. Kjo vjen nga që në analizën e veprave letrare është injoruar fakti se pasqyrimi njohës i karaktereve në vetëdijen e shkrimtarit ngërthen në vetvete edhe qëndrimin e tij aktiv emocional-ideologjik. Duke u injoruar drejtimi ideo-emocional i shkrimtarit në veprat letrare, këto të fundit janë shikuar kryesisht si pasqyrim pasiv i jetës, si ilustrim artistik i fakteve dhe i ngjarjeve të saj.

Në studimet dhe në punimet historiko-letrare si dhe në artikujt kritikë mungon një sistem termash unik, i qartë dhe i studjuar në pikëpamje teorike. Paqartësi ka sidomos në përdorimin e termit realizëm. Shpesh realizmi, si anë e caktuar e brendisë së një vepre letrare, ngatë-

rrohet me anë të tjera të saj. Kështu, në studimet kushtuar krijimtarisë së Çajupit, të Mjedës dhe të letërsisë së viteve '30 shfaqja e realizmit si parim i ri në pasqyrimin e jetës barazohet me trajtimin e temës shoqërore, me idetë demokratike. Parimi realist i paraqitjes së realitetit s'ka të bëjë me temën e veprës; një vepër realiste mund të shkruhet edhe mbi një temë historike edhe mbi historinë e një familjeje ose mbi kontradiktat e brendshme shpirtërore të një njeriu.

Mungesa e përfytyrimit të qartë mbi rrymat dhe mbi drejtimet letrare ka çuar në përcaktime jobindëse të disa fenomeneve historiko-letrare. Në vëllimin e dytë të historisë së letërsisë shqipe prodhimi letrar i Konicës, i Fishtës dhe i Sqiroid futet në një emërtim të përbashkët: «rrymë oportuniste dhe reaksionare», e cila më vonë zhvillohet në «rrymën letrare të klerit katolik të veriut». Po pak më poshtë të gjithë shënohen me një emërtim të ri: «tendencat antidemokratike në letërsinë shqipe». Si rrjedhim letërsia borgjeze dhe klerikale katolike konsiderohet dhe si rrymë dhe si tendencë, kurse krijimtaria e shkrimtarëve përparimtarë të shquar të Rilindjes cilësohet thjesht: «tendencë demokratike». Kur nisi të studjohet prodhimi i letrarëve përparimtarë, që hynë në letërsi në vitet '30, u përdor përcaktimi «brezi i viteve '30», ose «brezi i vitit 1935». Tashti ky emërtim pothuajse ka dalë nga moda, por në vend të tij mbeti «letrarët e viteve '30» që nuk sqaron në se këta përbënin rrymë apo drejtim letrar.

Të gjitha këto raste flasin për nevojën e ngutshme të përpunimit të një sistemi koherent dhe të qartë nocionesh dhe termash teoriko-letrare.

* * *

Jeta e sotme e vendit ka shtruar përpara shkencës sonë për letërsinë detyra të mëdha dhe shumë të rëndësishme, zgjidhja e të cilave kërkon punë këmbëngulëse dhe frymë krijuese.

Studjuesit tanë të letërsisë i kanë të gjitha mundësitë për t'u dalë mbanë faqebardhë këtyre detyrave. Mbështetja e shëndoshë në këtë rrugë është metodologjia marksiste-leniniste, janë materialet e Kongresit V, vendimet e Partisë dhe fjalimet e shokut Enver Hoxha mbi problemet e revolucionarizimit të jetës së vendit dhe në mënyrë të veçantë mbi detyrat e frontit të kulturës dhe të shkencave shoqërore.

R é s u m é

QUESTIONS D'ETUDE DE L'HISTOIRE DE LA LITTÉRATURE ALBANAISE

Dans l'article ci-contre, l'auteur se propose de fixer certaines questions qui se font jour actuellement dans le domaine de l'étude de l'histoire de la littérature albanaise.

Faisant une estimation positive aux résultats obtenus durant la période du pouvoir populaire dans l'étude de la littérature albanaise de la

Renaissance nationale, notamment pour ce qui est de l'élaboration d'une juste conception, en grandes lignes, sur le processus de son développement à la fin du XIX^e — commencement du XX^e siècle, l'auteur insiste sur la tâche qui se dresse devant les spécialistes à corriger une suite d'estimations subjectives de maints aspects de l'oeuvre et de la conception des écrivains éminents de la Renaissance, tels que N. Frashëri, N. Mjeda, et d'autres, qui portent à l'idéalisation de ces auteurs.

Dans quelques études des écrivains albanais d'Italie, fait observer l'auteur, notamment sur de Rada et A. Santori, on n'a pas considéré à fond leurs positions sociales et politiques, leur évolution d'idées dans différentes phases du mouvement de libération et antiféodal, les illusions qu'ils entretenaient envers les forces politiques différentes.

Une tâche importante est à étudier profondément les courants littéraires qui ont vu le jour et se sont développés durant la Renaissance nationale, le genèse de classe des courants d'idées qui ont donné naissance aux différents courants littéraires, le rôle qu'elles ont joué dans l'histoire de la littérature et de la culture albanaise.

L'auteur croit que pour les études dans le domaine de la littérature des années 20-30 de notre siècle, qu'on entreprendra bientôt, il est de la plus haute importance à mettre au clair la couche historique et sociale sur laquelle elle a vu le jour, son contenu d'idées, son caractère.

L'analyse effective et exacte scientifique des faits historiques et littéraires confirme qu'il s'agit d'une littérature démocratique, intimement rattachée au mouvement général démocratique contre la monarchie féodalo-bourgeoise d'A. Zogu, contre le joug politique et le dur pressurage économique, contre l'arbitraire de l'appareil administratif pourri, contre les principes et les formes rétrogrades dans la vie sociale et familiale, contre la politique antinationale de soumission envers l'impérialisme italien.

En partant de ces conceptions, l'auteur refuse la thèse de maints étudiants qui considèrent cette littérature une littérature socialiste, et même du réalisme socialiste. La considération de Noli et de Migjeni comme écrivains du réalisme socialiste découle d'une conception estompée du contenu historique de la période des années 20-30 et d'une conception inexacte du réalisme socialiste.

Une attention toute particulière doit être consacrée à l'étude de la littérature actuelle albanaise qui se développe dans les conditions du pouvoir populaire, et dont l'étude ne vient que de commencer. Dans ce domaine, se font jour des problèmes très importants, comme l'examen des prémisses historico-sociales et historico-littéraires de la naissance de cette littérature, de la formation de la méthode du réalisme socialiste dans le reflet de la vie, des étapes qu'a franchies la littérature contemporains depuis sa naissance jusqu'à nos jours, des caractéristiques qui font distinguer chacune des étapes et de la contribution qu'elle a donné au développement et à l'enrichissement de la création littéraire-artistique, etc.

Il est d'une extrême importance à mettre au clair, notamment comment les écrivains contemporains ont résolu les principaux problèmes littéraires, comme le reflet du nouveau héros, né dans la lutte pour la transformation radicale du pays, des masses populaires en tant que facteur fondamental du développement historique, etc. De l'importance à notamment l'étude du développement actuel de la littérature, l'étude des tendances et des processus qui se déroulent dans son sein, etc.

Une attention soutenue doit être consacrée à démasquer les théories et les thèses de la science bourgeoise et révisionniste. En lutte contre ces théories, on doit défendre et faire développer plus loin les principes de la science marxiste-léniniste sur la littérature, les principes de l'art du réalisme socialiste.

Pour pouvoir s'en acquitter dûment de ces grandes tâches, les spécialistes de l'histoire de la littérature albanaise doivent avoir une préparation solide au point de vue scientifique. C'est pour cela que se porte au premier plan la question de l'assimilation plus profonde et plus organique de la méthode marxiste-léniniste, de la consolidation de leur préparation théorique.

